

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN LABINOT MAL, ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Labinot-Mal Elbasan**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifave vendore, administrimin e aseteve, dhënieve me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 56, datë 30.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 312/6, datë 02.6.2014, i ka rekomanduar z. Qani Xhafa Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga titullari i Komunës Labinot Mal Elbasan, të merren të gjitha masat për riorganizimin e zyrës së të ardhurave vendore me specialistë me arsim të lartë përkatës me qëllim rritjen e efektivitetit, parashikimin real të të ardhurave vendore mbështetur në të dhënat aktuale dhe realizimet e mëparshme.

Menjëherë

2. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të merren masa për hartimin e planit vjetor të kontroleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”*, pika 10, “Kontrolli tatimor”.

Menjëherë

3. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore që arkëtohen nga njësitet e tjera publike (D.P.SH.T.RR, ZVRPP) etj, duke bërë rakordime periodike më të plotë të taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit. Kjo duke ushtruar të drejtën ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor, të cilët duhet të sjellin ndryshime në rritje të treguesve të planifikimit, realizimit në fakt të ardhurave si dhe dokumentacionit të mbajtur për këtë qëllim.

Vazhdimisht

4. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e financës dhe Zyrat e tjera të Komunës, të merren masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e **debitorëve** të pa likuiduara deri më datën 31.12.2013 në vlerën **3,174, mijë lekë, përkatësisht:** për taksën e biznesit të vogël nga 21 subjekte në vlerën 393,000 lekë, taksën e tokës bujqësore nga 740 familje në vlerën 1,934,000 lekë, taksën e banesave nga 740 familje në vlerën 449,000 lekë, tarifën e ujit të pijshëm nga 126 familje në vlerën 347, 000 lekë, tarifën e transportit nga dy subjekte në vlerën 51,000 lekë.

Vazhdimisht

5. Zyra e taksave dhe tarifave vendore të hartoj regjistrin themelor të subjekteve fizik, juridik dhe abonentëve familjarë, për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave vendore, në

zbatim të nenit 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Brenda muajit Qershor 2014

6. Zyra e taksave dhe tarifave vendore të njoftojë të gjithë abonentët familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ata kanë për taksat dhe tarifatat vendore, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe të mbajë evidencë për ecurinë e përmbushjes së këtyre detyrimeve në një regjistër të veçantë, me qëllim aplikimin e masave të tjera në rast mospërmbushje të detyrimeve.

Vazhdimisht

7. Nga titullari i Komunës Labinot Mal Elbasan, të merren të gjitha masat për vlerësimin e aseteve, regjistrimin e tyre në ZVRPP, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, në zbatim me kërkesat e VKM nr.

500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM. nr. 808, datë 04.06.2008 dhe VKM. nr. 456, datë 06.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Labinot-Mal, të Qarkut Elbasan”, me qëllim sigurimin e të ardhurave për Komunën.

Menjëherë

8. Nga titullari i Komunës Labinot Mal Elbasan dhe zyra e financës të merren të gjitha masat për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ndërtesës të mullirit të blojës dhe makineri e pajisje elektrike të instaluar në të si aset të Komunës, regjistrimin e tij sipas ligjit për kontabilitetin.

Menjëherë

9. Nga titullari i Komunës Labinot Mal Elbasan dhe zyra e shërbimeve të merren të gjitha masat për sigurimin e dokumentacionit të sipërfaqes së ndërtimit dhe asaj funksionale të instaluar nga antena e “A...” si aset i Komunës, regjistrimin e saj në kontabilitet dhe në ZVRPP Elbasan dhe dhënien e saj me qira.

Menjëherë

10. Për përfitimin e ndihmës ekonomike të familjeve të ndara nga trangu familjar të gjithë aplikantëve domosdoshmërisht tu kërkohet edhe ndarja e aktit të marrjes tokës në pronësi e vitit 1991 dhe regjistrimi i saj në ZVRPP Elbasan.

Vazhdimisht

11. Për 13 familjet përfituese padrejtësisht të ndihmës ekonomike në vlerën 710,900 lekë të ndërpritet dhënia e ndihmës ekonomike dhe në rast mos plotësimi të dokumentacionit ligjor të kërkohet në të gjitha rrugët ligjore arkëtimi i vlerës së përfituar padrejtësisht.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Komuna Labinot-Mal Elbasan të kontabilizojë dhe nisë procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit: **në shumën 281,336 lekë në ngarkim të:**

1.Të kontabilizohen dhe të ndiqet arkëtimi i detyrimeve të pa arkëtuara sipas rekomandimeve të lëna nga audit i brendshëm nga viti 2010 në vlerën **173,489** lekë prej të cilave nga 72 familje në vlerën 60,989 lekë dhe 10 subjekte biznesi në vlerën 112,500 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2014

2. Nga operatori ekonomik A.B. në vlerën **50,000 lekë** për ditë vonesë në zbatimin e afatit të kontraktuar për shërbimin e detyrës së projektimit të rrugë Xibrakë- Sericë.

Brenda muajit Korrik 2014

3. Nga operatori ekonomik Th.D. në vlerën **22,882 lekë** për përfitim më tepër nga llogaritja e tarifës së kolaudimit të punimeve në objektin “Ndërtim Ura e fshatit Bozhiq” në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me VKM nr.444, datë 05,09,1994 “Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”.

Brenda muajit Korrik 2014

4. Nga operatori ekonomik L.P. në vlerën **34,965 lekë** për përfitim më tepër nga llogaritja e tarifës së mbikëqyrjes të punimeve në objektin “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare e fshatit Guri i zi” në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me VKM nr.444, datë 05,09,1994 “Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”.

Brenda muajit Korrik 2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe në nenin 12 të kontratës individuale të punës i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Labinot-Mal Elbasan, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, **për 8 punonjësit** si më poshtë:

a. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, sipas nenit 12 (Sanksione të kontratës individuale të punës)

1. **z. S.H.** me detyrë nën kryetar i Komunës në cilësinë e anëtarit në njësinë e prokurimit dhe në komisionin e prokurimit me vlera të vogla.
2. **z. N.K.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.
3. **z. A.H.** me detyrë specialist në njësinë e prokurimit dhe në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Për shkeljet e konstatuara në zbatimin e detyrave të lëna nga auditi i brendshëm, në hartimin dhe miratimin e buxhetit, në kontabilizimin e detyrimeve për të ardhurat vendore dhe në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012 dhe 2013.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”, kreun VI pika 2 “Prokurimi me vlerë të vogël” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.2.2008 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore”, nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, neni 73, deri në nenin 106, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4. **z. M.K.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

5. z. R.M. me detyrë inspektor i administrimit të pyjeve dhe kullotave dhe në cilësinë anëtarit të KVO dhe të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Për shkeljet e konstatuara në administrimin e pronave, inventarizimin, regjistrimin pranë ZVRPP Elbasan, vlerësimin dhe zbatimin e një plani menaxhimi e mbarështimi në asetet e qëndrueshme, veprim i cili bie në kundërshtim, me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”*, VKM nr. 22, datë 9.01.2008, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”*, pikat 3, 4 e në vijim.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012 dhe 2013 dhe inventarizimin, vlerësimin, regjistrimin e aseteve, pyjeve dhe kullotave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar në kreun VI pika 2 *“Prokurimi me vlerë të vogël”* të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr.2, datë 18.2.2008 *“Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”*, i ndryshuar dhe nenin 106, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

6. z. Sh.B. me detyrë inspektor i taksave vendore.

-Për shkeljet e konstatuara në hartimin dhe miratimin e buxhetit, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave vendore dhe mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin në zbatim të nenit 32 *“Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”* të ligjit 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor”*, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore”*.

7. z. R.B. me detyrë inspektor i ndihmës ekonomike

-Për shkeljet e konstatuara në trajtimin e familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike në dokumentacionin e pronësisë së tokës, për shkeljet e konstatuara në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012 dhe 2013 si anëtar i komisionit të blerjeve dhe shërbimeve në vlera të vogla, veprime në kundërshtim me germën “ç” dhe “d” pika 2 të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 *“Për përcaktimin e kriterëve dhe masës së ndihmës ekonomike”*, kreun VI pika 2 *“Prokurimi me vlerë të vogël”* të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.2.2008 *“Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”*, i ndryshuar.

b. “Ulje në detyrë”, sipas nenit 13 (Sanksione të kontratës individuale të punës)

8. z. H.SH. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së taksave vendore.

-Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në hartimin dhe miratimin e buxhetit, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave vendore dhe mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin në zbatim të nenit 32 *“Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”* të ligjit 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor”*, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore”*.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Halil Isufi, Rezart Golemaj dhe Selman Hysaj më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT